

FLETA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Sika MonoTop®-110 QuickFix

LLAÇ ME MPIKSJE TË SHPEJTË GATI PËR PËRDORIM

PËRSHKRIMI I PRODUKTIT

Sika MonoTop®-110 QuickFix është llaç prej 1 përbërësi, me mpiksje të shpejtë dhe gati për përdorim me bazë lidhësi (binder) çimentoje dhe agregatesh të përzgjedhura i krijuar si një llaç për fiksime që karakterizohet nga zhvillimi i hershëm i rezistencave.

PËRDORIMET

Sika MonoTop®-110 QuickFix është krijuar veçanërisht për të gjitha punimet ku nevojitet llaç me ngurtësim të shpejtë, p.sh.:

- Fiksim mbështetësesh, kapakësh, tubacionesh
- Instalim dyersh dhe dritaresh të blinduara
- Ankorim piketash, thurimash, gardhi

KARAKTERISTIKA / AVANTAZHE

- Mpiksje pas disa minutash
- Ambalazh praktik, gjithashtu i përshtatshëm për aplikime të vogla
- Mpiksje e shkëlqyer edhe në kushte të lagështa
- I përshtatshëm për lyerje pasi materiali të jetë tharë
- Ndërkapje e mirë mbi metale

INFORMACIONE MBI PRODUKTIN

| | |
|-----------------------|--|
| Baza kimike | Çimento, agregate të përzgjedhura dhe aditivë |
| Ambalazhi | Qese alumini 5 kg të paketuara në kuti kartoni që përmban 4 copë |
| Paraqitja / Ngjyra | Pluhur gri |
| Jetëgjatësia | 12 muaj |
| Kushtet e magazinimit | Të magazinohet saktë në ambalazhin origjinal, të padëmtuar dhe të mbyllur, në kushte të thata dhe të freskëta. |
| Dendësia | Dendësia e llaçit të freskët ~1.8 kg/l |

TË DHËNA TEKNIKE

| | | | |
|---------------------------|---------------|------------|------------|
| Rezistenca ndaj ngjeshjes | Koha | Rezistenca | (EN 196-1) |
| | Pas 3 orësh | ~ 6 MPa | |
| | Pas 28 ditësh | ~ 24 MPa | |

INFORMACIONE PËR APLIKIMIN

| | |
|--|--|
| Raporti i përzjerjes | 0.95 deri në 1.05 litra uji për 5 kg pluhur. 19 % – 21 % ujë për peshë pluhuri |
| Konsumimi | Në varësi të ashpërsisë së nënshtresës dhe trashësisë së shtresës së aplikuar. Sa për udhëzim, ~20 kg pluhuri për cm trashësie për m ² . |
| Rendimenti | 5 kg pluhuri prodhon afërsisht 3.36 litra llaçi. |
| Temperatura e mjedisit | +5 °C min.; +30 °C max. |
| Temperatura e nënshtresës | +5 °C min.; +30 °C max. |
| Koha e punueshmërisë | ~1–2 minuta në +23 °C dhe 50 % lagështi relative Koha është me përafërsi dhe do të ndikohet nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit dhe detajet e aplikimit. |
| Koha e mpiksjes | ~2–3 minuta në +23 °C dhe 50 % lagështi relative Koha është me përafërsi dhe do të ndikohet nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit dhe detajet e aplikimit. |
| Produkti i aplikuar gati për përdorim | ~2 orë në +23 °C dhe 50 % lagështi relative Koha është me përafërsi dhe do të ndikohet nga kushtet e ndryshueshme të mjedisit dhe detajet e aplikimit. |

UDHËZIME APLIKIMI

CILËSIA E NËNSHTRESËS / PËRGATITJA

Nënshtresa duhet të jetë e qëndrueshme dhe pa pluhur, ndotje, grimca të lira, kontaminime sipërfaqësore si vaj ose graso, kore çimentoje. Betoni i shpetëzuar, i dobët, i dëmtuar dhe i shkatërruar duhet të hiqet me mjetet e përshtatshme. Sipërfaqet duhet të përgatiten me teknika pastrimi mekanik.

PËRZIERJA

Sika MonoTop®-110 QuickFix mund të përzihet me përzierës elektrik në xhiro të ulët. Në sasi të vogla produkti mund të përzihet edhe me dorë. Hidhni ujin në konteinerin për përzierje. Ndërsa jeni duke përzierë ngadalë, shtoni pluhurin tek uji dhe përzieni plotësisht. Hidhni ujë shtesë gjatë përzjerjes nëse nevojitet deri në sasinë maksimale të specifikuar dhe adaptoni sipas konsistencës së kërkuar. Sigurohuni që të përzieni vetëm atë sasi produkti që mund të aplikohet brenda 2-3 minutave.

APLIKIMI

Lagni plotësisht të gjithë nënshtresën e përgatitur. Përpara aplikimit të llaçit, hiqni ujin e tepruar me një sfungjer të pastër. Sipërfaqja duhet të ketë paraqitje mat të errët dhe pa shkëlqim dhe poret sipërfaqësore nuk duhet të përmbajnë ujë. Aplikoni Sika MonoTop®-110 QuickFix me mallë ose shpatull. Duhet të vendoset shpejtë te hapësira që duhet të mbushet, duke ushtruar presion të madh midis nënshtresës dhe elementit që do të fiksohet në mënyrë që të sigurohet ndërkapje e mirë mbi të dyja nënshtresat. Mbani në vend objektin që do të fiksohet derisa llaçi të fillojë të ngurtësohet dhe mund të përballojë ngarkesa.

METODA E MATURIMIT

Mbroni menjëherë llaçin e freskët nga tharja e parakoshme duke përdorur një metodë të duhur trajtimi p.sh. përbërës trajtimi, membranë gjeotekstile lagështie, fletë polietilene, etj.

MIRËMBAJTJA E MJETEVE

Pastroni të gjitha veglat dhe pajisjen e aplikimit me ujë menjëherë pas përdorimit. Materiali i ngurtësuar mund të hiqet vetëm mekanikisht.

KUFIZIME

- Në temperatura të larta (25°C – 30°C) përdorni ujë të ftohtë për të ruajtur një kohë të pranueshme punueshmërie
- Në temperatura të ulëta (5°C – 8°C) përdorni ujë të ngrohtë për të përshpejtuar kohën e mpiksjes së llaçit
- Përzieni sasinë e produktit që mund të vendoset brenda 2–3 minutave
- Aplikoni vetëm mbi nënshtresë të qëndrueshme dhe të përgatitur
- Mos shtoni ujë mbi dozën e rekomanduar
- Mos shtoni ujë tek llaçi që ka filluar të mpikset
- Mos shtoni ujë shtesë gjatë finiturës së sipërfaqes pasi kjo gjë do të shkaktojë çngjyrosje dhe plasaritje
- Shmangni aplikimin në diell të drejtpërdrejtë dhe/ose erë të fortë
- Mbroni materialin e sapoaplikuar nga ngrirja

BAZA E TË DHËNAVE TË PRODUKTIT

Të gjitha të dhënat teknike që deklarohen në këtë fletë me të dhënat e produktit bazohen mbi prova laboratorike. Të dhënat reale të matura mund të ndryshojnë për shkak të kushteve që nuk janë nën kontrollin tonë.

KUFIZIME LOKALE

Ju lutemi të keni parasysh se si rezultat i rregulloreve të posaçme lokale performanca e këtij produkti mund të variojë nga një shtet në tjetër. Ju lutemi, këshillohuni me fletën e të dhënave të produktit (botimin lokal) për të dhënat e sakta të produktit.

EKOLOGJI, SHËNDET DHE SIGURI

Për informacione dhe udhëzime rreth përdorimit, magazinimit dhe asgjësimit të sigurt të produkteve kimike, përdoruesit duhet t' i referohen Fletës me të Dhënat e Sigurisë (Safety Data Sheet, SDS) më të fundit, e cila përmban të dhëna fizike, ekologjike, toksikologjike dhe të tjera që lidhen me sigurinë gjatë përdorimit të produktit.

SHËNIME LIGJORE

Informacionet dhe në veçanti sugjerimet që kanë të bëjnë me aplikimin dhe përdorimin përfundimtar të produkteve të Sika-s, ofrohen me mirëbesim dhe bazohen mbi njohuritë aktuale dhe përvojën e kompanisë për produktet kur ato magazinohen, përdoren dhe aplikohen nën kushte normale në përputhje me sugjerimet e Sika-s. Në veprim e sipër, dallimet tek materialet, nënshtresat dhe kushtet lokale të aplikimit, janë të tilla sa që asnjë garanci nuk mund të jepet në lidhje me tregtimin apo përshtatshmërinë e tyre për një synim konkret dhe nuk mund të ngarkohet asnjë përgjegjësi nga e cila mund të krijohet çfarëdolloj afere ligjore kundër kompanisë në bazë të informacioneve që përmenden këtu, sugjerimeve me shkrim apo informacioneve të dhëna në çfarëdolloj forme tjetër. Përdoruesit e produkteve duhet të kontrollojnë përshtatshmërinë e tyre për çdo aplikim dhe qëllim përdorimi. Sika ruan të drejtën e ndryshimit të vetive të produkteve të saj. Ruajtja e të drejtave të personave të tretë është e detyrueshme. Të gjitha porositë pranohen sipas kushteve të kompanisë rreth shitjes dhe dorëzimit. Përdoruesit e produkteve duhet gjithnjë të referohen në botimin më të fundit lokal të fletës me të dhënat e produktit, kopjet e të cilave do të jepen sipas kërkesës.

Sika Albania SHPK

Rruga e Rinasit, Tirana Business Park

Ndërtesa nr. 7, kati 4

Tiranë - Shqipëri

Tel.: +355 4 454 0070

alb.sika.com

Email: info@al.sika.com



Fleta e të dhënave të produktit
Sika MonoTop®-110 QuickFix
Shkurt 2019, Botimi 01.01
020201010030000102

SikaMonoTop-110QuickFix-sq-AL-(02-2019)-1-1.pdf